



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE
KOMISIONI I PROVIMEVE TË AFTËSIVE PROFESIONALE**

**Zbatimi në praktikë i kërkesave të legjislacionit të tatimeve dhe taksave
në Republikën e Shqipërisë.**

20 Tetor 2018

Seksioni I

**Pyetje me alternativa (1 pikë secila).
Zgjidhni alternativën e saktë.**

1. Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH-së”, përcakton që:
 - a) Tatimi është pagesa e detyrueshme dhe e pakthyeshme në Buxhetin e Shtetit apo në buxhetin e organeve të qeverisjes vendore, e vendosur me ligj dhe që paguhet nga çdo person, që ushtron një të drejtë publike apo përfiton një shërbim publik në territorin e Republikës së Shqipërisë;
 - b) Tatimi është pagesa e detyrueshme dhe e pakthyeshme në Buxhetin e Shtetit aponë buxhetin e organeve të qeverisjes vendore, e vendosur me ligj dhe që nuk bëhet nëshkëmbim të mallrave dhe shërbimeve të caktuara;
 - c) Tatimi është detyrimi monetar i detyrueshëm për t’u paguar si shpërblim për një shërbim specifik apo ushtrim të të drejtave, për sigurimin shoqëror dhe shëndetësor të të punësuarve;
 - d) Tatimi është një rimbursim, i cili duhej kryer nga administrata tatimore;

Përgjigja e saktë është alternativa (B)

2. Me njoftimin e kontrollit tatimor, tatimpaguesit i jepet mundësia të deklarojë çdo të dhënë për sanksione të padeklaruara, për të cilat nuk është paguar tatim. Për detyrimin tatimor të deklaruar përpara fillimit të kontrollit tatimor aplikohet dënim administrativ në masën:
 - a) 100 për qind të tatimit ose kontributit;
 - b) 50 për qind të tatimit ose kontributit;
 - c) 30 për qind të tatimit ose kontributit;
 - d) 10 për qind të tatimit ose kontributit;

Përgjigja e saktë është alternativa (B)

3. Tatimpaguesi mund të ankimojë kundër çdo njoftim vlerësimi. Tatimpaguesi, i cili kërkon të ankimojë:

- a) Duhet të paraqesi vetëm kërkesën me shkrim pranë Drejtorisë së Apelimit Tatimor;
- b) Duhet të paraqesi kërkesën me shkrim dhe bëjë pagesën e plotë të detyrimit, se bashku me gjobat e përfshira në vlerësimin tatimor të ankimuar;
- c) Duhet të paraqesi kërkesën me shkrim dhe bëjë pagesën e plotë të detyrimit, kamatvonesave, se bashku me gjobat e përfshira në vlerësimin tatimor të ankimuar;
- d) Duhet të paraqesi kërkesën me shkrim dhe bëjë pagesën e plotë të detyrimit tatimor, nga ku përjashtohen gjobat e përfshira në vlerësimin tatimor të ankimuar;

Përgjigja e saktë është alternativa (D)

4. Në taksat vendore nuk përfshihen:

- a) Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin;
- b) Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme;
- c) Taksa mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror në përdorim;
- d) Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja;

Përgjigja e saktë është alternativa (C)

5. Autoritetet doganore duhet të marrin masat, me anë të të cilave synohet, në veçanti:

- a) Mbrojtja e interesave financiarë dhe mjedisorë të Republikës së Shqipërisë nga tregtia e padrejtë dhe e paligjshme, duke mbështetur ndërkohë aktivitetin e ligjshëm të biznesit;
- b) Garantimi i sigurisë e i mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe i banorëve të saj, si dhe mbrojtjes së mjedisit e, kur është e nevojshme, në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet e tjera;
- c) Alternativa a) dhe b);
- d) Asnjë alternativë nuk është e saktë;

Përgjigja e saktë është alternativa (C)

6. Në pagën bruto, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe sigurimin ekujdesit shëndetësor, nuk përfshihen:

- a) Shpërblimet me karakter të përhershëm;
- b) Honoraret apo shpërblimet e tjera të kësaj natyre, që kanë lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës;
- c) Përfitimet që punëmarrësi merr nga fondet e sigurimeve shoqërore;
- d) Anjëra nga alternativat;

Përgjigja e saktë është alternativa (C)

7. Nga mbrojtja dhe sigurimi i detyrueshëm shoqëror përjashtohen shtetasit e huaj që:

- a) Punojnë në subjekte të huaja, të cilat, në bazë të një marrëveshjeje, nuk kanë detyrimin për t'u regjistruar në organet tatimore shqiptare;
- b) Janë të punësuar në subjekte të huaja, që nuk kanë detyrimin për t'u regjistruar në organet tatimore shqiptare, të cilët vijnë në Shqipëri të punojnë në një punë apo shërbim të kualifikuar, sipas një kontrate shërbimi, të lidhur me një subjekt të regjistruar në organet tatimore shqiptare, i cili nuk është degë apo njësi e subjektit kontraktor. Zgjatja e kohës së qëndrimit dhe shërbimit është sipas përcaktimeve në ligjin nr. 108/2013 "Për të huajt";
- c) Që janë të përjashtuar nga pagimi i kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe të sigurimit të kujdesit shëndetësor në Shqipëri, në bazë të një marrëveshjeje të lidhur midis shtetit të tyre me shtetin shqiptar;
- d) Të gjitha të mësipërmet;

Përgjigja e saktë është alternativa (D)

8. I vetëpunësuar dhe i vetëpunësuar që punëson të tretë, me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi, të paguajë për vete një kontribut të detyrueshëm për sigurimet shoqërore:

- a) Në masën 23% të pagës, por jo më pak se paga minimale mujore dhe sipas përcaktimit të vetë personit, deri në nivelin e pagës maksimale për efekt të kontributeve shoqërore;
- b) Të barabartë me 20,000 lekë në muaj;
- c) Të masën 3.4% të dyfishit të pagës minimale mujore, e barabartë me 1 496 lekë në muaj;
- d) Në masën 5% të pagës, por jo më pak se paga minimale mujore dhe sipas përcaktimit të vetë personit, deri në nivelin e pagës maksimale për efekt të kontributeve shoqërore;

Përgjigja e saktë është alternativa (A)

9. Një shoqëri italiane e regjistruar në Itali kontrahet nga një shoqëri Kosovare e regjistruar në Kosovë dhe realizon projektin e një qendre tregtare që do të ndërtohet në Tiranë. Vendi i furnizimit të shërbimit të projektimit të qendrës tregtare është:

- a. Në Itali
- b. Në Kosovë
- c. Në Shqipëri
- d. Të gjitha të mësipërmet

Përgjigja e saktë është alternativa (C)

10. Cili është kufiri i detyrueshëm i të ardhurave vjetore bruto, që detyron një individ të deklarojë të ardhurat e tij personale:

- a. 8 milion lekë /vit
- b. 5 milion lekë/vit
- c. 2 milion lekë/vit
- d. Asnjëra prej tyre

Përgjigja e saktë është alternativa (C)

Seksioni II

Administrimi i detyrimeve tatimore në RSH, procedurat që zbatohen për mbledhjen e tatimeve dhe detyrimeve të tjera tatimore. Struktura e tatimeve dhe taksave. Autoritetet përgjegjëse të taksave në nivel kombëtar e vendor.

11. Tatimpaguesi, subjekt i TVSH-së, është i detyruar të regjistrojë menjëherë të gjitha veprimet financiare dhe përgatit e mban libra e regjistra kontabël.
Çfarë regjistrohet konkretisht në librat dhe regjistrat kontabël?

4 pikë

Përgjigje:

Tatimpaguesit, që janë subjekt i TVSH-së ose i tatim-fitimit, për përlogaritjen e detyrimit tatimor, mbajnë regjistrat, dokumentacionin kontabël, librat dhe informacionin financiar, si dhe lëshojnë faturë tatimore, dëftesë tatimore ose kupon tatimor, në përputhje me ligjet e fushës, si dhe aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të tyre.

Tatimpaguesi, subjekt i TVSH-së, regjistron të gjitha transaksionet dhe veprimet financiare dhe përgatit e mban libra e regjistra kontabël, ku, pa u kufizuar vetëm në to, regjistrohen:

- a) shitjet e përditshme të mallrave ose kryerja e punimeve apo e shërbimeve të tatueshme, përfshirë shumën e secilit veprim dhe shumën e tatimit të ngarkuar;
- b) punimet apo shërbimet e përfunduara, por akoma të pafaturuara;
- c) transaksionet e patatueshme;
- ç) pagesat për mallra dhe shërbime, përfshi shumën e secilës blerje apo pagesë, shumën e tatimit të paguar dhe emrin e adresën e furnizuesit;
- d) arkëtimet dhe pagesat.

12. Çfarë është vlerësimi tatimor? Kur dërgohet njoftimi i vlerësimit tatimor dhe çfarë informacionesh (elementesh) duhet të përmbajë?

5 pikë

Përgjigje:

Vlerësimi tatimor është llogaritja e detyrimit tatimor të tatimpaguesit nga administrata tatimore. Në rastet kur shuma e detyrimit tatimor të vetëdeklaruar nuk paguhet, është njoftimi, që kërkon pagesën e detyrimit tatimor në datën e përcaktuar në ligjin përkatës.

Nëse administrata tatimore konstaton se detyrimi tatimor, i dhënë në deklaratën tatimore, është i pasaktë ose tatimpaguesi nuk ka dorëzuar deklaratë tatimore apo nuk ka paguar detyrimin tatimor, administrata tatimore bën vlerësimin tatimor.

Administrata tatimore, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e llogaritjes së vlerësimit prej saj, i dërgon tatimpaguesit njoftimin e vlerësimit tatimor dhe kërkesën për pagesën e detyrimit tatimor, në rrugë elektronike (kur tatimpaguesit kanë dhënë pëlqimin për pranimin e njoftimit në rrugë elektronike) ose nëpërmjet shërbimit postar rekomande.

Njoftimi i vlerësimit tatimor dhe kërkesa për pagesën e tatimit duhet të përmbajë informacionin, si më poshtë:

- a) emrin dhe mbiemrin e tatimpaguesit, person fizik, ose emrin e personit juridik;
- b) numrin e identifikimit të tatimpaguesit;
- c) datën e njoftimit;
- ç) çështjen, për të cilën bëhet njoftimi dhe periudhën ose periudhat tatimore, që u referohet njoftimi;
- d) shumën e tatimit të vlerësuar apo, sipas rastit, edhe uljen e humbjes tatimore, uljen e kredisë tatimore, kamatëvonesën, gjrobat;
- dh) kërkesën për pagesën e tatimit dhe afatin e pagesës;
- d) vendin dhe mënyrën e pagesës së tatimit;
- ë) shpjegimin e arsyes së vlerësimit;
- f) shpjegimin e së drejtës së tatimpaguesit për të ankimuar vlerësimin.

13. Në zbatim të legjislacionit tatimor, tatimpaguesi jo-rezident emëron një përfaqësues tatimor rezident, kur kjo i kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Kush mund të jetë përfaqësuesi tatimor rezident? Cilat janë hapat dhe procedurat që ndjek përfaqësuesi tatimor rezident për tu regjistruar si i tillë?

5 pikë

Përgjigje:

Përfaqësuesi tatimor rezident mund të jete një individ, një person fizik tregtar ose një person juridik. Personi i emëruar si përfaqësues tatimor ka të drejtë të veprojë në emër të kryesorit të tij (personit jo rezident) për të gjitha qëllimet që lidhen me tatimet. Ai është njëkohësisht përgjegjës për të përmbushur të gjitha detyrimet e tatimpaguesit jo-rezident që ai përfaqëson.

Brenda 5 ditëve pasi të jetë caktuar, përfaqësuesi tatimor duhet të dorëzojë aplikimin për regjistrim në drejtorinë e shërbimit dhe të regjistrimit të tatimpaguesit në drejtorinë rajonale tatimore, ku është regjistruar si tatimpagues ose në rastin e individit, aty ku ka vendin e zakonshëm të residences. Sëbashku me aplikimin për regjistrim, i cili, bëhet me plotësimin dhe paraqitjen e formularit “Kërkesë për regjistrim”, personi i caktuar si përfaqësues tatimor duhet të paraqesë gjithashtu:

1. Vendimin ose prokurën e caktimit apo emërimit të përfaqësuesit tatimor, të nënshkruar nga personi përgjegjës i personit të tatueshëm jorezident që ka emëruar përfaqësuesin. Vendimi i emërimit të përfaqësuesit tatimor duhet të tregojë veprimet që përfaqësuesi tatimor është i autorizuar të kryejë në emër të personit që përfaqëson;
2. Një kopje të vërtetuar të marrëveshjes së përfaqësimit tatimor ndërmjet aplikuesit për përfaqësues tatimor dhe personit që ai përfaqëson;
3. Një kopje të vërtetuar nga autoritetet tatimore të shtetit përkatës, të certificates së regjistrimit tatimor të personit jorezident në vendin e tij të rezidencës, e lëshuar jo më përpara se 3 muaj nga data e aplikimit për regjistrim të përfaqësuesit, ku të vërtetohet se personi jorezident është person aktiv.

Në marrëveshje duhet të specifikohen qartë të gjitha aktivitetet, të cilat mund të ushtrohen nga përfaqësuesi tatimor. Përfaqësuesi tatimor, të paktën, duhet të jetë i autorizuar:

- i) të plotësojë faturat në emër të personit që përfaqëson, për transaksionet për të cilat përfaqësuesi tatimor është autorizuar;
- ii) të pranojë faturat për transaksione për të cilat përfaqësuesi tatimor është i autorizuar;
- ii) të dorëzojë deklaratatë TVSH-së në Shqipëri në emër të personit që përfaqëson, si dhe deklarata të tjera tatimore kur ato i kërkohen ngalejislacioni tatimor në fuqi në Republikën e Shqipërisë;
- iv) të paguajë detyrimet tatimore dhe të marrë rimbursimet tatimore nëse ka të tilla në emër të personit jorezident që përfaqëson.
- v) të mbajë regjistrimet e transaksioneve për të cilat përfaqësuesi tatimor është caktuar dhe t’ia vendosë, ato në dispozicion me kërkesë të administratës tatimore;
- vi) të veprojë në emër dhe përlogari të personit jorezident dhe ta përfaqësojë atë në kontrollet e mundshme të administratës tatimore;
- vii) të plotësojë të gjitha detyrimet që lidhen me TVSH-në në importe, eksporte dhe detyrime doganore, nëse ka të tilla.

- 14.** Në datën 20 tetor të vitit 2017, një tatimpagues ka kryer shitje malli në vlerën 100,000 lekë, ndërsa fatura me TVSH që ka lëshuar është në vlerën 60,000 lekë dhe më pas ka deklaruar tek FDP e TVSH-së shumën e TVSH prej 10,000 lekë ($60,000 / 6 = 10,000$ lekë).

A është deklaruar drejtë vlera e mallit? Çfarë procedure duhet të ndjekë tatimpaguesi për ta korrigjuar atë?

6 pikë

Përgjigje:

Jo vlera e mallit nuk është deklaruar drejt. Tatimpaguesi duhet të bëjë vetë-korrigjimin. Për këtë arsye, tatimpaguesi do të lëshojë një faturë në të cilën do të përcaktojë vlerën e tatueshme 50, 000 lekë dhe TVSH -në përkatëse 10, 000 lekë. Në deklaraten e muajit korrent, tek FDP e TVSH-së, tatimpaguesi do të shtojë vlerën e TVSH nga vetë korrigjimi prej 10,000 lekë. Tatimpaguesi do të gjenerojë nga sistemi urdhërpaguesën përkatëse dhe shuma e detyrimit që ai duhet të paguajë do të përfshijë përveç detyrimit të urdhërpaguesës, edhe kamatë-vonesën përgjithë periudhën e mospagimit në kohë të detyrimit, e cila do të përlllogaritet nga vetë tatimpaguesi. Gjithashtu, në të njëjtën mënyrë tatimpaguesi do të veprojë për të korrigjuar të njëjtën vlerë të nëndeclaruar për llogaritjen dhe pagimin e tatimit mbi fitimin, apo tatimit të thjeshtuar mbi fitimin apo tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël.

- 15.** Shoqëria X është shoqëri anonime që ushtron aktivitet tregtar me objekt “shitje me shumicë të karburanteve”. Drejtorja Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj, gjatë kontrollit të ushtruar në dokumentacionin e shoqërisë, ka konstatuar dhe ka njoftuar palën paditëse për detyrime të papaguara. Me Njoftim-Vlerësimin për detyrimet, nr.23702/5 prot., datë 26.11.2017, shoqëria X është detyruar të paguajë shumën 5.449.872 lekë, si detyrim që buron nga tatimi, kamatëvonesat dhe gjobat, të krijuara, gjatë ushtrimit të aktivitetit tregtar. Mbasi ka paguar detyrimin, pa gjobat dhe kamatvonesat, shoqëria X i është drejtuar Drejtorisë së Apelit Tatimor për të kundërshtuar Njoftim-Vlerësimin.

Si duhet të veprojë Drejtorja e Apelit Tatimor, çfarë duhet të vendosë dhe përse?

7 pikë

Përgjigje:

Në nenin 106 të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” është parashikuar se cilat akte përbëjnë objekt të kundërshtimit administrativ, forma e ankimit, organi të cilit i drejtohet ankimi, si edhe afati brenda të cilit, duhet të paraqitet ankimi. Konform këtij neni tatimpaguesi mund të ankimojë kundër çdo njoftim vlerësimi apo çdo vendimi që ndikon në detyrimin e tij tatimor. Ankimi bëhet me shkrim dhe tatimpaguesi duhet ta dorëzojë ankimin në drejtorinë e apelit tatimor brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur vlerësimi ose vendimi i administratës tatimore është marrë ose vlerësohet të jetë marrë nga tatimpaguesi. Ndërsa, në nenin 107 të ligjit “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” ligjvënësi ka parashikuar që, së bashkë me ankesën, tatimpaguesi duhet të paguajë shumën e plotë të detyrimit tatimor, ose të vendosë garanci bankare, me qëllim që ankimi i tij të merret në shqyrtim. Dhe ky nen thekson se shuma e pagueshme ose

shuma e vënë si garanci bankare përjashton gjrobat e përfshira në vlerësimin tatimor të ankimuar.

Detyrimi tatimor konform nenit 6/3 të ligjit përfshin: tatimin, kamatëvonesat, si dhe gjrobat. Si pasojë, në interpretim të dispozitave ligjore të mësipërme, për t'u marrë në shqyrtim ankimi administrativ, duhet që të parapaguhet detyrimi tatimor, i cili duhet të ketë të përfshirë tatimin dhe kamatëvonesat.

Për rrjedhojë, nisur nga fakti se shoqëria X nuk e ka bërë pagesën e kamatëvonesave, Drejtoria e Apelimit Tatimor duhet të vendosë *“Refuzimin e ankimit, për shkak se e konsideron ankimin të papranueshëm, pasi nuk është kryer pagesa e detyrimit tatimor (kamatëvonesat)”*.

Seksioni III

Tatimet Mbi të Ardhurat

- 16.** Përshkruani dokumentacionin që duhet të përdoret për rastet e promociioneve dhe promovimit, që shpenzimet të njihen si të zbritshme për efekt fiskale.

4 pikë

Përgjigje:

Dokumentacioni që duhet të përdoret për rastet e promociioneve dhe promovimit janë:

- Vendimi i asamblesë së ortakëve ose administratorit ku të jenë të përcaktuar vendi, perioda e organizimit të promocionit, sasia e produkteve që do të shpërndahen, materialet publicitare që do të përdoren, etj.
- Projekt – ideja lidhur me mënyrën e organizimit të promocionit dhe promovimit.
- Proçes - verbali për produktet që shpërndahen me personat që përfitojnë produktin falas
- Fletë shoqërimi malli, me ekstreme të plotësuar, ku tek marresi i mallit do të firmosin promovuesit e shoqërisë. Fleta e shoqërimit të mallit do të jetë ditore për çdo promovues të cilës duhet ti bashkangjiten në fund të ditës process verbalet e mbajtura me personat përfitues.

Dokumentacioni që duhet të përdoret për dhënien e dhuratave simbolike:

- Vendimi i asamblesë së ortakëve ose administratorit për llojin dhe sasinë totale të mallrave që dhurohen dhe kujt do t'i dhurohen.

- 17.** Listoni sipas kategorisë përkatëse :

- Shkallët tatimore;
- Afatet e parapagimit;

5 pikë

Përgjigje:

Shkallët tatimore për tatimin mbi të ardhurat/ fitimin janë:

0% për bizneset që realizojnë një qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 5 (pesë) milionë lekë

5% për bizneset që realizojnë një qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë.

15% për bizneset e mëdha, ato që realizojnë një qarkullim vjetor mbi 8 000 000 lekë dhe

5% për personat juridikë, të cilët ushtrojnë aktivitet për prodhimin / zhvillimin e *software-ve*,

Prej 1 janar 2019 shkallët ndryshojnë si më poshtë:

- 5 % për tatimpaguesit me të ardhura deri në 14 000 000 lekë në vit.
- 15 % për tatimpaguesit me të ardhura mbi 14 000 000 lekë në vit.
- 5% për personat juridikë, të cilët ushtrojnë aktivitet për prodhimin/zhvillimin e *software-ve*,
- 5% për personat juridikë, të cilët zhvillojnë veprimtari ekonomike sipas ligjit nr. 38/2012, “Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor”
- 5% për subjektet, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si “agroturizëm”, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit. Kjo shkallë aplikohet për një periudhë 10-vjeçare për personat juridikë që përfitojnë statusin “subjekt i certifikuar agroturizmi”, deri më 31 dhjetor 2021.

Afatet e parapagimit

Bizneset që realizojnë një qarkullim nga 5 në 8 Milion lekë në vit paguajnë paradhëniet e kësteve, sipas afateve:

- brenda datës 20 Prill pagesa e këstit I;
- brenda datës 20 Korrik pagesa e këstit II;
- brenda datës 20 Tetor pagesa e këstit III;
- brenda datës 20 Dhjetor pagesa e këstit IV.

Këstet e paradhënieve të tatimit mbi fitimin, për bizneset që realizojnë një qarkullim më të madh se 8 milion lekë në vit paguhen në bazë tremujore ose në bazë mujore.

Afatet e pagesës së kësteve tremujore të paradhënieve janë:

- i) për tremujorin e parë (janar-shkurt-mars) të vitit, brenda datës 30 mars;
- ii) për tremujorin e dytë (prill-maj-qershor) të vitit, brenda datës 30 qershor;
- iii) për tremujorin e tretë (korrik-gusht-shtator) të vitit, brenda datës 30 shtator;
- iv) për tremujorin e katërt (tetor-nëntor-dhjetor) brenda datës 30 dhjetor.

Kur këstet e paradhënieve të tatimit mbi fitimin paguhen në bazë mujore, afati i pagesës është brenda datës 15 të çdo muaji.

18. Albert Xibri gjatë vitit 2017 rezulton të ketë përfituar këto lloje të ardhurash personale:

- a. Të ardhura nga paga në vit si drejtor i menaxhimit të shitjeve, i punësuar në një shoqërinë tregtare Delta shpk, gjithësej 1.200.000 lekë; (paga mujore 100.000 lekë)
- b. Interesat nga depozita e kursimit, të cilat nuk i ka tërhequr nga banka, 100.000 lekë;
- c. Shpërblim nga shoqëria ku punon për një fatkeqësi familjare që i ndodhi 50.000 lekë;

- d. Ka përfituar të ardhura nga qeraja 250.000 lekë, pasi ka lëshuar me qera një garazh pronë të tij;
- e. Nga shpronësimi i një sipërfaqe toke që dispononte, ku do të kalojë autostrada ai ka përfituar gjithsej 2.500.000 lekë;
- f. Ka përfituar pagesë 3.000.000 lekë kompensim si ish i dënuar politik;
- g. Është paguar nga shtëpia botuese me 500.000 lekë si e drejtë autori, në lidhje me një libër të tij të botuar.
- h. Të ardhura nga konsulenca e dhënë për një institucion publik në shumën 450,000 Të llogaritet shuma e tatimit mbi të ardhurat personale që paguan ky individ për vitin 2017.

7 pikë

Përgjigje:

- a) $(100,000 - 30,000) \times 13\% = 9100 \times 12 = 109,200$ lekë
- b) $100,000 \times 15\% = 15,000$ lekë
- c) e përjashtuar
- d) $250,000 \times 15\% = 37,500$
- e) e përjashtuar
- f) e përjashtuar
- g) $500.000 \times 15\% = 75,000$ lekë

Në total për vitin 2017, Alber Xibri duhet të paguajë 236.700 lekë Tatim mbi të ardhurat e tij personale.

- 19.** Shoqëria tregtare ABC sh.a, e cila është rezidente në Shqipëri, vendos të shpërndajë një dividend në masën 1,000.000 lekë. Struktura aksionere të shoqërisë është:
- Shtetasi Albert Molla ka 15% të aksioneve të shoqërisë ABC sha dhe është Resident në Shqipëri. Shoqëria tregtare Driloni shpk zotëron 35% të aksioneve dhe e ka selinë në Pogradec
- Shoqëria VITRALIANA srl zotëron 50% të aksioneve dhe e ka selinë në Verona Itali
- Pyetje:** Të llogaritet tatimi në burim që duhet të mbajë dhe të paguajë shoqëria ABC sha si tatim mbi dividendin, për secilin nga aksionerët e saj. Midis Shqipërisë dhe Italisë ekziston Marrëveshja për eliminimin e tatimit të dyfishtë. Mund të përfitojnë palët nga Marrëveshja në këtë situatë? Nqs po, përshkruani në detaje procedurat që duhet të ndiqen.

7 pikë

Përgjigje:

- Shoqëria tregtare ABC sha shpërndan dividend në vlerat respektive: shtetasi Albert Molla ka 15% dhe përfiton $(1,000,000 \times 15\%) \times 15\% = 150,000$ dividend –Tatim mbi dividendin 22,500 lekë
- Shoqëria Driloni Pogradec $(1,000,000 \times 35\%) = 350,000$ lekë –Nuk tatohet për dividendin
- Shoqëria VITRALIANA srl me seli në Verona, Itali $(1,000,000 \times 50\%) = 500\ 000$ lekë.

Meqënëse midis Shqipërisë dhe Italisë është në fuqi Marrëveshja për eliminimin e Taksimit të Dyfishtë, kjo Marrëveshje prevalon (ka epërsi) ndaj Ligjit të brendshëm. Si rrjedhojë, përpara taksimit duhet t'i referohemi Marrëveshjes, në kapitullin për dividendin. Marrëveshja mund t'i japë të drejtën shoqërisë VITRALIANA srl ta paguajë në Itali tatimin mbi këtë të ardhur ose të përfitojë nga ndonjë shkallë e reduktuar tatimore në Shqipëri. Për këtë arsye, Shoqëria VITRALIANA srl fillon procedurat tip ndërmjet dy administrative tatimore Itali dhe Shqipëri, për zbatimin e Marrëveshjes dhe për të përfituar nga termat lehtësuese të saj.

Seksioni IV

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

20. Si përcaktohet koeficienti i zbritjes së pjesshme të TVSH-së dhe cilat janë rregullat për aplikimin e koeficientit të zbritjes?

5 pikë

Përgjigje:

Bazuar në Udhëzimin për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, nëse furnizimet e mallrave dhe shërbimeve përdoren nga një person itatueshëm, si për kryerjen e transaksioneve të tatueshme që sjellin të drejtën e zbritjes së TVSH-së, edhe për transaksionet që nuk e sjellin këtë të drejtë (transaksione të përjashtuara nga TVSH-ja), atëherë vetëm pjesa e TVSH-së që lidhet me përdorimin e furnizimeve për kategorinë e transaksioneve të tatueshme është e zbritshme. Llogaritja e zbritjes së pjesshme të TVSH-së bëhet në bazë të koeficientit të zbritjes së TVSH-së. **(1 pikë)**

- a) Koeficienti i zbritjes së TVSH-së përcaktohet mbi bazë vjetore, përcaktohet në përqindje dhe rrumbullakoset në maksimum me njësinë më të lartë si më poshtë:

(1 pikë)

$$Kz = \frac{\text{furnizime të tatueshme}}{\text{furnizime të tatueshme} + \text{furnizime të përjashtuara}} \times 100$$

- b) Koeficienti i zbritjes së TVSH-së, e aplikueshme provizorisht për një vit, është koeficienti fillestar i zbritjes dhe ky koeficient llogaritet mbi bazën e transaksioneve të vitit të mëparshëm. Në mungesë të këtyre transaksioneve ose kur shuma e tyre është e papërfillshme, koeficienti fillestar i zbritjes së TVSH-së vlerësohet provizorisht prej vetë personit të tatueshëm, në bazë të parashikimeve të tij dhe nën mbikëqyrjen e administratës tatimore. **(1 pikë)**

- c) Zbritja e TVSH-së, e kryer mbi bazën e koeficientit fillestar të zbritjes, duhet të rregullohet në periudhën e parë tatimore të vitit pasardhës, sipas koeficientit përfundimtar të zbritjes së TVSH-së. **(1 pikë)**

d) Personi i tatueshëm duhet të njoftojë administratën tatimore për koeficientin fillestar të zbritjes së TVSH-së që do të aplikojë gjatë vitit dhe për mënyrën e llogaritjes së saj, jo më vonë se:

1. data 31 janar, në rastin kur nuk është viti i parë i aplikimit të koeficientit të zbritjes së TVSH-së. Në këtë rast koeficienti fillestar i zbritjes së TVSH-së është koeficienti përfundimtar i zbritjes së TVSH-së për vitin paraardhës. **(0.5 Pikë)**

2. Afati i deklarimit të periudhës së parë tatimore, në të cilën lind detyrimi për të aplikuar koeficientin fillestar të zbritjes së TVSH-së. **(0.5 pikë)**

21. Shpjegoni çfarë konsiderohet si dhuratë me vlerë të vogël dhe çfarë konsiderohet si mostra (kampione).

A janë këto furnizime kundrejt pagesës?

5 pikë

Përgjigje:

a) Ligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar përcakton se nuk konsiderohen si furnizim kundrejt pagesës, rastet kur një person i tatueshëm përdor, shfrytëzon mallra të biznesit si dhurata me vlerë të vogël apo mostra (kampione).

Si parim kur mallrat merren apo përdoren nga ndërmarrja konsiderohen si furnizim kundrejt pagesës të tatueshme me TVSH. Brenda kësaj kategorie përfshihen pikërisht mallrat që merren për qëllime private dhe nuk përdoren për realizimin e transaksioneve të tatueshme nga ndërmarrja ose kur këto mallra nuk përdoren për nevojat e shfrytëzimit të saj. Marrja e një “malli me vlerë të vogël” të transferuar pa pagesë nga mallrat e ndërmarrjes nuk është furnizim kundrejt pagesës në kuptim të ligjit dhe nuk kërkohet të zbatohet TVSH nëse plotësohen të dy kushtet e mëposhtme njëkohësisht:

1. Përdorimi kryhet për nevojat e veprimtarisë ekonomike.

2. Përdorimi lidhet me një mostër (kampion) ose me një objekt me vlerë të vogël **(2pikë)**

b) Mostër (kampion) konsiderohen ato objekte të lidhura drejtpërdrejtë me kryerjen e aktiviteteve të personave të tatueshëm, që i ofrohen konsumatorëve, klientëve të zakonshëm apo atyre potencial dhe nuk janë për qëllime shitje. Këto objekte nuk janë për qëllime shitje ose nuk shiten pasi kanë trajtën që pamundëson shitjen e tyre. Mallrat që jepen si mostra biznesi duhet të jenë të shenjëzuara si të tilla dhe duhet ta kenë trajtën ose paketimin ndryshe krahasuar me mallrat (objektet) të cilat kanë për qëllim shitjen. **(1.5 pikë)**

c) Dhuratë me vlerë të vogël, konsiderohet një mall me vlerë individuale të tregut më të vogël se 2.000 lekë, që shpërndahet pa pagesë për qëllim të zgjerimit, publicitetit dhe promovimit të veprimtarisë ekonomike të personit të tatueshëm, të cilën personi i tatueshëm ia jep konsumatorëve të rregullt ose konsumatorëve potencial. Në rastin kur dhuratat janë nga mallrat e biznesit ky rregull lejohet të zbatohet vetëm për një objekt për të njëjtin përfitues dhe vetëm një herë në vit, pavarësisht vlerës së mallit, por jo më shumë se vlera e përcaktuar. Duhet të provohet qartësisht nga ana e personit të tatueshëm që një dhuratë me vlerë

nën 2,000 lekë është përfituar vetëm për një objekt, njëherë të vetme nga i njëjti klient përgjatë një viti. **(1.5 pikë)**

22. Një person i tatueshëm me TVSH shet mallra të përdorur. Gjatë muajit x lëvizjet e mallrave të përdorur kanë qënë si vijon:

Malli	Blerje (njësi)	Shitje (njësi)
1	100	50
2	20	60
3	200	100
4	0	100
5	40	160

Gjendja e mallrave në fillim të muajit ka qënë si vijon:

Malli	Gjendja (njësi)
1	100
2	50
3	0
4	200
5	150

Cmimet e mallrave janë si vijon:

Malli	Cmim Blerje (ALL)	Cmim shitje (ALL)
1	100	200
2	50	60
3	130	200
4	1,000	2,500
5	25,000	40,000

Shpjegoni trajtimin e TVSH-së për veprimet e mësipërme si dhe kerkesat në lidhje me lëshimin e faturës së TVSH-së.

7 pikë

Përgjigje:

Rasti në fjalë ka të bëjë me shitjen e mallrave të përdorur, aktivitet të cilin Ligji për TVSH-në e rregullon me Regjimin i Marzhit të Fitimit, i cili bën të mundur tatimin me TVSH mbi vlerën e marzhit të transaksioneve të shitjes.

Regjimi i Marzhit të Fitimit aplikohet për furnizimet e kryera nga një person i tatueshëm rishitës i mallrave të përdorura, të cilat i janë furnizuar atij brenda territorit të Republikës së Shqipërisë nga personat si më poshtë:

a) një person që nuk është i tatueshëm për TVSH-në; **(0.5 pikë)**

b) një person i tatueshëm, nëse furnizimi i mallrave që ai kryen përjashtohet nga TVSH-ja, ose furnizon mallra, për të cilat nuk ka pasur të drejtën e zbritjes së TVSH-së; **(0.5 pikë)**

c) një person tjetër i tatueshëm rishitës, në qoftë se furnizimi i mallrave prej këtij të fundit i është nënshtruar TVSH-së, në përputhje me këtë skemë të marzhit; **(0.5 pikë)**

d) një person i tatueshëm, i cili është subjekt i regjimit për bizneset e vogla dhe furnizimi që kryhet ka të bëjë me mall kapital të përfshirë në aktivet afatgjata. **(0.5 pikë)**

Personi e tatueshëm ri-shitës nuk ka të drejtë të zbresi TVSH-në në lidhje me blerjet brenda vendit përse kohë furnizimet e tij taten sipas regjimit të marzhit, por gëzon të drejtën të kreditojnë TVSH-në e mallrave apo shërbimeve të blera me qëllim konsumin dhe përdorimin e tyre, për qëllime të realizimit të aktivitetit të tij të tatueshëm me TVSH. **(1 pikë)**

Në zbatim të këtij regjimi vlera e tatimit për t'u paguar "TVSH mbi marzhin" sipas regjimit të marzhit të fitimit llogaritet sipas formulës më poshtë: **(3 pikë)**

- Çmimi i shitjes -ÇSH përbën vlera totale të faturës së lëshuar nga personi i tatueshëm ri-shitës.
- "Çmim blerje- ÇB" është vlera totale e paguar ose për t'u paguar furnizuesit të mallit.
- "Shkalla tatimore-20%" e zbatuar nga personi i tatueshëm rishitës nën këtë regjim është shkalla standarde e TVSH-së.

$$\text{TVSH mbi marzhin} = [(\text{ÇSH} - \text{ÇB}) / (100\% + 20\%)] \times 20\%$$

Malli	Vlera e gjendjes	Vlera e blerjeve	Vlera totale gjendje për t'u shitur	Vlera e shitjeve
1	10,000	10,000	20,000	10,000
2	2,500	1,000	3,500	3,600
3	-	26,000	26,000	20,000
4	200,000	-	200,000	250,000
5	3,750,000	1,000,000	4,750,000	6,400,000
TOTALI	3,962,500	1,037,000	4,999,500	6,683,600

Malli	Vlera totale gjendje për t'u shitur	Vlera e shitjeve	Marzhi pozitiv	Marzhi negativ	TVSH e pagueshme
1	20,000	10,000		(10,000)	
2	3,500	3,600	100		16,67
3	26,000	20,000		(6,000)	
4	200,000	250,000	50,000		8,333
5	4,750,000	6,400,000	1,650,000		275,000
TOTALI	4,999,500	6,683,600	1,700,100	(16,000)	283,333

Personi e tatueshëm rishitës, i cili zbaton regjimin e marzhit total në faturën e lëshuar për çdo furnizim, nuk duhet të llogarisë apo të pasqyrojë të ndarë vlerën e TVSH-së në faturën e lëshuar. Në çdo faturë të lëshuar që i nënshtrohet regjimit të marzhit, personi i tatueshëm ri-shitës duhet të shënojë: “Shitje që i nënshtrohet regjimit të marzhit të fitimit”. Tatimi deklarohet dhe paguhet në deklaratën e TVSH-së në kutinë përkatëse vlera e tatueshme dhe TVSH mbi marzhin. **(1 pikë)**

- 23.** Një organizatë jo fitim prurëse kryen eksport në Shtetin X disa mallrave të blera në Shqipëri, për qëllim të veprimtarisë së saj humanitare. Vlera pa TVSH e këtyre mallrave është 1,000,000 Lekë, TVSH është 200,000 Lekë.

Shpjegoni trajtimin e TVSH-së në rastin më sipër, si dhe procedurën që duhet të kryej organizata jo fitim prurëse pranë autoriteteve doganore dhe pranë autoriteteve tatimore në lidhje me TVSH-në si dhe kushtet që duhet të përmbush organizata për të fituar të drejtën e rimbursimit të TVSH-së.

6 pikë

Përgjigje:

Eksporti i mallrave jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, prej organizatave jofitimprurëse si pjesë e veprimtarisë së tyre humanitare, bamirëse jashtë Shqipërisë në kuadër të marrëveshjeve të posaçme është furnizim me shkallën zero të TVSH-së. **(0.5 pikë)**

TVSH e paguar në blerje për këto mallra, të destinuara për eksport për përmbushjen e qëllimit bamirës të tyre, e dokumentuar me faturën përkatëse tatimore të blerjes është e rimbursueshme. Pra, vlera prej 200,000 Lekësh e paguar për blerjet e mallrave brenda vendit mund të rimbursojë nga organizata. **(0.5 pikë)**

Për të realizuar procedurën e rimbursimit të këtyre organizatave ato i nënshtrohen procedurës së mëposhtme:

- a) Në momentin e eksportit këto organizata duhet të paraqesin pranë autoritetit tatimor, që kryhen procedurat e eksportit, faturat origjinale të blerjes së tyre. Lloji, sasia dhe vlera e mallrave të eksportuara duhet të përputhet me llojin, sasinë dhe vlerën e mallrave të blera sipas faturave tatimore origjinale të blerjes së këtyre mallrave në Shqipëri. Blerësi i mallrave në faturë duhet të jetë organizata jofitimprurëse (Emër, Nipt) që kryen eksportin. Faturat e blerjes së mallrave duhet të kenë lidhje direkte me mallrat që eksportohen dhe të mos jenë përdorur në Republikën e Shqipërisë. **(1.5 pikë)**
- b) Në momentin e kryerjes së procedurave të eksportit pranë autoritetit doganor, organizata jofitimprurëse plotëson një formular në të cilin deklarohen në mënyrë analitike të gjitha faturat e blerjes së mallrave që eksportohen me emrin e personit të tatueshëm shitës, nr serial, datë, vlera e tatueshme, TVSH dhe vlera totale sipas faturave. Në përfundim të procedurës ky dokument vulloset nga autoriteti doganor dhe një kopje i vihet në dispozicion organizatës. **(1 pikë)**

- c) Pasi është kryer eksporti i mallrave, për rimbursimine TVSH-së organizata jofitimprurëse paraqet pranë Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve ku është e regjistruar, kërkesën për rimbursim të TVSH-së dhe bashkangjitur dokumentacionin si vijon: **(2 pikë)**
- i) Fotokopje të noterizuar të certifikatës së Nipt-it;
 - ii) Fotokopje të noterizuar të faturave origjinale të blerjes;
 - iii) Deklaratën e eksportit në të cilën organizata që kërkon rimbursimin duhet të jetë eksportuesi i mallit;
 - iv) Një kopje e noterizuar e marrëveshjes së posaçme me organizatën për të cilën mallrat janë destinuar, e cila duhet të jetë e vendosur jashtë Shqipërisë. Pritësi (destinuesi) i mallit në deklaratën e eksportit dhe organizata, e cila është palë në marrëveshjen e posaçme, duhet të përputhen;
 - v) Një kopje e noterizuar e formularit të plotësuar dhe vulosur nga autoriteti doganor sipas procedurës së mësipërme. Shuma e TVSH-së sipas faturave për të cilat kërkohet të rimbursohet TVSH duhet të jetë e njëjtë me shumën e TVSH-së që rezulton në formularin e plotësuar nga autoriteti doganor në momentin e eksportit të justifikuar me deklaratën doganore të eksportit;
 - vi) Një deklaratë ku jep informacion për nr. e llogarisë në të cilën do të rimbursohet TVSH.

Për të fituar të drejtën e rimbursimit të TVSH, organizatat që i nënshtrohen procedurës së më sipër nuk duhet të kryejë veprimtari ekonomike qoftë edhe dytësore. Ajo duhet të jenë qartësisht me qëllim mirëbërës dhe humanitar dhe shpërndajë falas pa pagesë mallrat që blen.**(0.5 pikë)**

Seksioni V

Taksat Vendore Direkte

- 24.** Arjani zotëron një apartament me sipërfaqe 120 m² në qytetin e Tiranës me vlerë të vetdeklaruar prej 7 200 000 lekë. Nga verifikimet e bëra nga njësia e taksave vendore të Bashkisë Tiranë, vlera për m² e apartamenteve në të njëjtën zonë është 65 000 lekë për m² e përcaktuar në mënyrë të besueshme dhe sipas kushteve të tregut, si dhe vlera sipas cmimit mesatar referues është 64 000 lekë për m². Sa është detyrimi vjetor i taksës së pasurisë që duhet të paguajë Arjani?

4 pikë

Përgjigje:

Hapi i parë është krahasimi i vlerave të dhëna në rastin e mësipërm duke i kthyer në njësi të njëjta matje, sipërfaqe për m². Në këtë rast vlera e vetedeklaruar nga Arjani do të jetë

$$7\,200\,000 \text{ lekë} / 120 \text{ m}^2 = 60\,000 \text{ lekë për m}^2$$

Nga shqyrtimi i të dhënave do merren në krahasim vlera e vetdeklaruar prej 60 000 dhe vlera e marrë nga njësia e taksave vendore prej 65 000 lekë. Kjo zgjedhje bëhet për faktin që bashkia Tiranë ka arritur të marrë një vlerë të saktë tregu për m2 të apartamentit, pa qenë nevoja për marrjen në konsideratë të cmimit mesatar referues. Si rrjedhojë vlera e taksës vjetore të pasurisë do të llogaritet si më poshtë:

Cmim për m2 x sipërfaqe x normë e taksës = 65 000 x 120 x 0,05% = **3 900 lekë**

Seksioni VI

Akcizat dhe Taksat Doganore

25. Jepni përkufizimin e “Duty free shop”. Cilat janë specifikat e “Duty free shop” në lidhje me aplikimin e akcizës? **4 pikë**

Përgjigje:

“Duty free shop” është çdo ndërtesë e vendosur brenda një aeroporti ose porti që plotëson kushtet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Mallrat e akcizës që lëvrohen nga Duty free shops dhe që merren në bagazhet personale nga udhëtarët që lënë territorin shqiptar në rrugë ajrore dhe detare përjashtohen nga pagesa e akcizës. Konsiderohen si mallra të lëvruara nga Duty free shops edhe mallrat e lëvruara në bordin e avionit gjatë një udhëtimi ndërkombëtar.

Seksioni VII

Kontributet e detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore

26. ABC dhe BCD janë të dypunësuar dhe përfitojnë përkatesisht, pagë bruto prej 80,000 Lekë dhe 40,000 Lekë tek punëdhënësi tjetër. Nderkohë në Shoqërinë GAMA ata kanë paga bruto përkatësisht 29,000 dhe 95,000 Lekë. Llogarisni detyrimet për kontribute shoqërore dhe shëndetësore që punëdhënësi duhet të deklarojë dhe paguajë për të dy punonjësit për muajin Qershor 2018.

4pikë

Përgjigje:

Kur i njëjti person është ekonomikisht aktiv në dy ose më shumë subjekte dhe në secilin prej tyre merr pagë më të lartë se paga minimale, llogaritja e kontributit të sigurimit shoqëror dhe sigurimit të kujdesit shëndetësor është e detyrueshme për çdo subjekt. Në këtë rast, llogaritja e kontributit të sigurimit të kujdesit shëndetësor bëhet sipas pagës përkatëse, që merr nga secili subjekt, ndërsa masa e llogaritur e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në total, të **jetë jo më shumë se kontributi i llogaritur mbi pagën maksimale;**

Punëdhënësi i parë për punonjësin ABC do të paguajë:

Sigurime shoqërore 80,000 x 15% = 12,000 lekë

Sigurime shëndetësore 80,000 x 1.7 % = 1,360 lekë

Gjithsej

13,360 leke

Shoqëria GAMA për punonjësin ABC do të deklaroj edhe paguaj

ABC meqenëse ka deklaruar kontribute shoqërore mbi pagën prej 80,000 Leke te subjekti "Punedhenesi 1" me NIPT..... paga bruto mbi të cilën do të përlogariten detyrimet për sigurime shoqërore në Shoqërinë Gama do të jete si me poshtë:
 $105,850 - 80,000 = 25,850$ Leke.

Sigurime shoqërore	(105,850 – 80,000)	$25,850 \times 15 \%$	= 3,877 lekë
Sigurime shendetësore (nuk ka tavan)		$29,000 \times 1.7 \%$	= <u>493</u> lekë
Gjithsej			4,371 lekë

BCD përfiton një page me të lartë në Shoqërinë ABC dhe si rrjedhojë paga bruto që merr në këtë shoqëri do të shërbejë si pagë bruto mbi të cilën deklarohen kontribute shoqërore. Në rast se paga bruto > 105,850 Lekë (paga maksimale), atëherë 105,850 do të shërbejë si paga bruto mbi të cilën përlogariten detyrimet për kontribute shoqërore

Subjekti I parë për punonjësin BCD do të deklaroj edhe paguaj

Sigurime shoqërore	(105,850- 95,000)	$10,850 \times 15 \%$	= 1,627 lekë
Sigurime shendetësore (nuk ka tavan)		$40,000 \times 1.7 \%$	= <u>680</u> lekë
Gjithsej			2,308 lekë

Shoqëria GAMA për punonjësin BCD do të deklaroj edhe paguaj

Sigurime shoqërore	$95,000 \times 15 \%$	= 14,250 lekë
Sigurime shendetësore	$95,000 \times 1.7 \%$	= <u>1,615</u> lekë
Gjithsej		15,865 lekë

27. Znj. ABC në cilësinë e Inxhinieres kishte filluar punë në muajin korrik 2018 në Shoqërinë "Construction" me pagë mujore bruto prej 130,000 Lekë dhe bonus performance në fund të shtatorit (me karakter jo të përhershëm) në vlerën prej 75,000 Lekë. Cdo muaj Shoqëria i siguron antidote në vlerën mujore prej 7,000 Lekë. Gjithashtu Znj. A është edhe administratore në Shoqërinë "SMART" ku përfiton një page mujore bruto prej 80,000 Lekë.

Llogarisni detyrimet për kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore që Kompania edhe Znj. ABC duhet të paguajnë për shtator 2018.

5 pikë

Përgjigje:

Në pagën bruto, për efekt të llogaritjes së **kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe sigurimin e kujdesit shëndetësor, nuk përfshihen:**

d) vlera e antidoteve, që punëdhënësi jep në natyrë, për personat e punësuar, sipas legjislacionit në fuqi;

dh) shpërblimet me karakter jo të përhershëm, të lejuara në mbështetje të legjislacionit në fuqi, shpërblimet nga fondi i veçantë, për rastet e fatkeqësive në familje, për sëmundjet e gjata, për dëme, në raste fatkeqësish të mëdha natyrore, dhe për veprimtari të shquara;

Shoqëria Construction për znj.ABC do të deklaroj edhe paguaj për maksimumin

Sigurime shoqërore $105,850 \times 15 \% = 15,877.5$ lekë

Sigurime shëndetësore (nuk ka tavan) $130,000 \times 1.7 \% = \underline{2,210}$ lekë

Gjithsej 18,087.5 lekë

Znj ABC nëShoqërinë Construction do të paguaj

Sigurime shoqërore $105,850 \times 9.5 \% = 10,056$ lekë

Sigurime shëndetësore (nuk ka tavan) $130,000 \times 1.7 \% = \underline{2,210}$ lekë

Gjithsej **12,266lekë**

Shoqëria SMART per znj.ABC do të paguaj

Sigurime shoqërore (sepse është paguar tek Shoqëria Construction për pagën maksimale) 0 lekë

Sigurime shëndetësore (nuk ka tavan) $80,000 \times 1.7 \% = \underline{1,360}$ lekë

Gjithsej **1,360 lekë**

Znj ABCnëShoqërinëSMART do të paguaj

Sigurime shoqërore (paguar tek Shoqëria Construction) 0 lekë

Sigurime shëndetësore (nuk ka tavan) $80,000 \times 1.7 \% = \underline{1,360}$ lekë

Gjithsej **1,360 lekë**